

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **651-26-4567-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Dezinfektimi,Dezinsektimi,DeratizimiI hapsirave ne institucionin public në Komunën e Gjilanit “**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	<b>MONUNI SH.P.K</b>
NUI	<b>811431238</b>
Adresa	<b>Rr. Washingtonit nr.65</b>
Vendi	<b>GJILAN</b>
Kodi postar	<b>60000</b>
Numri Telefonit	<b>043/555/655</b>
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	<b>Uron Maloku</b>
Adresa elektronike	<b>research@monuni.com</b>
Data e parashtrimit të ankesës	<b>01.07.2026</b>

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

#### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit  
Adresa e plotë  
Numri i Telefonit  
Numri i faks-it  
Adresa elektronike

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

**Dezinfektimi,Dezinsektimi,DeratizimiI hapsirave ne institucionin public në Komunën e Gjilanit “**

**Dosja e Tenderit -DDD 11.06.2026.doc. - 11.06.2026 11:25**

**Lista e cmimeve 10.06.2026.xlsx. - 10.06.2026 14:40**

**B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara - 12.06.2026 00:00**

**B05 Njoftim per Kontrat - 11.06.2026 00:00**

**Vendim per pezullim.PDF - 25.06.2026 14:40**

**Njoftim për zgjatjen e afatit rreth Kërkesës për Rishqyrtim 30.06.2026.pdf - 30.06.2026**

**Kërkesë për rishqyrtim - Kerkese per Rishqyrtim - DDD Komuna Gjilan.pdf - 30.06.2026**

**Kërkesë për rishqyrtim - Kërkesë për Rishqyrtim.pdf - 30.06.2026**

**Vendimi i kerkeses perryshqyrtim 30.06.2026.pdf - 30.06.2026 14:29**

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

**Përgjigje ndaj pretendimeve ankimore lidhur me parashtrimin e kërkesave për rishqyrtim dhe duke iu referuar edhe sqarimeve të paraqitura nga OE**

AK ju ka përgjigjur në pyetje sqaruese dhe duke shqyrtuar pretendimet ankimore në kërkesën për rishqyrtim, pa hyrë në shqyrtim të një nga një të pretendimeve, duke e pasur parasysh se janë të ndërlidhura njëra me tjetrën, AK ka vendosur t'i trajtojë bashkërisht dhe të përgjigjet si në vijim:

**Përgjigjet lidhur me projektin DDD**

Shërbimet DDD nuk përbëjnë vetëm aplikim teknik të biocideve, por janë masa të shëndetit publik që synojnë parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve infektive të transmetueshme nga vektorët dhe dëmtuesit. Sipas udhëzimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (WHO), kontrolli i vektorëve duhet të bazohet në mbikëqyrje epidemiologjike, vlerësim të rrezikut për shëndetin publik dhe vendimmarrje të bazuar në evidencë.

Prandaj, epidemiologu është profesionist kyç për identifikimin e rreziqeve epidemiologjike, analizimin e të dhënave mbi përhapjen e sëmundjeve. WHO thekson se programet e kontrollit të vektorëve duhet të mbështeten në mbikëqyrje epidemiologjike dhe kapacitete profesionale të shëndetit publik.

Po ashtu Bachelor i Shkencave të Mjekësisë Sanitare është i domosdoshëm për mbikëqyrjen e zbatimit të masave sanitare-higjienike, përdorimin e sigurt të produkteve biocide, kontrollin e kushteve mjedisore dhe respektimin e standardeve të shëndetit publik gjatë realizimit të aktiviteteve DDD.

Për këto arsye, kërkesa për këta profesionistë është proporcionale, profesionale dhe e domosdoshme për realizimin cilësor dhe të sigurt të shërbimeve të DDD-së. Kjo kërkesë nuk është diskriminuese, por lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe

**kompleksitetin e shërbimeve që prokurohen.**

**Lidhur me Kërkesën nr. 2, e cila parasheh që Operatori Ekonomik duhet të ketë së paku tre (3) punëtorë profesionalë me përvojë në fushën e DDD-së, të pajisur me Certifikatë për Aplikimin e Biocideve dhe Lëndëve DDD, si dhe pesë (5) Teknikë të Certifikuar në Integrated Pest Management (IPM), konsiderojmë se kjo kërkesë është e domosdoshme, proporcionale dhe në përputhje me natyrën e shërbimeve që prokurohen.**

**Shërbimet e Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit (DDD) janë aktivitete profesionale që përfshijnë përdorimin e biocideve dhe produkteve kimike të cilat, nëse nuk aplikohen nga personeli i trajnuar dhe kompetent, mund të paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut, kafshëve dhe mjedisit. Për këtë arsye, kompanitë moderne që operojnë në fushën e DDD-së duhet të disponojnë staf të trajnuar dhe të certifikuar, i cili zotëron njohuri profesionale mbi përdorimin e sigurt të biocideve, vlerësimin e rrezikut, masat mbrojtëse dhe procedurat e kontrollit të dëmtuesve.**

**Po ashtu, koncepti Integrated Pest Management (IPM) përfaqëson standardin bashkëkohor në menaxhimin e dëmtuesve, duke kombinuar monitorimin, identifikimin e saktë të dëmtuesve, masat parandaluese dhe përdorimin racional të produkteve kimike. Zbatimi efektiv i IPM kërkon personel të trajnuar dhe të certifikuar, i cili është në gjendje të ofrojë zgjidhje profesionale dhe të qëndrueshme në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare.**

**Kërkesa për të pasur punëtorë të certifikuar për aplikimin e biocideve dhe teknikë të certifikuar IPM lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe synon të garantojë që shërbimet DDD të kryhen në mënyrë profesionale, të sigurt dhe efektive. Duke pasur parasysh rëndësinë e mbrojtjes së shëndetit publik dhe nevojën për zbatim korrekt të masave DDD, disponimi i stafit të trajnuar nuk përbën kufizim të konkurrencës, por një kërkesë të arsyeshme dhe të domosdoshme për realizimin cilësor të kontratës.**

**Prandaj, Autoriteti Kontraktues vlerëson se kjo kërkesë është plotësisht e justifikuar nga aspekti teknik dhe profesional dhe mbetet e nevojshme për të siguruar ofrimin e shërbimeve sipas standardeve të kërkuara në fushën e DDD-së.**

**Sa i përket pretendimit lidhur me numrin e stafit profesional dhe pajisjeve të kërkuara në Dosjen e Tenderit, sqarojmë se licenca e lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) për kryerjen e shërbimeve DDD në Republikën e Kosovës përcakton kushtet minimale që duhet t'i plotësojë një operator ekonomik për t'u licencuar dhe për të ushtruar veprimtarinë në këtë fushë.**

**Megjithatë, fakti që legjislacioni parasheh minimumin e stafit përgjegjës dhe të pajisjeve të nevojshme për pajisje me licencë nuk nënkupton se ky minimum është i mjaftueshëm për realizimin e çdo kontrate publike, pavarësisht kompleksitetit, vëllimit dhe shtrirjes së saj.**

Në rastin konkret, objekti i kontratës përfshin një territor të gjerë të komunës, numër të konsiderueshëm institucionesh publike, shkolla, objekte administrative dhe hapësira të tjera që kërkojnë trajtim të vazhdueshëm dhe profesional në kuadër të shërbimeve DDD. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar se realizimi i suksesshëm i projektit kërkon angazhim më të madh të stafit profesional dhe disponueshmëri të pajisjeve shtesë përtej minimumit të kërkuar për licencim.

Kërkesa për numër më të madh të punëtorëve profesionalë dhe për pajisje shtesë është vendosur me qëllim të garantimit të kapaciteteve reale operative të operatorit ekonomik, përmbushjes së afateve të kontratës, mbulimit efikas të të gjitha lokacioneve të parapara dhe sigurimit të cilësisë së shërbimeve sipas standardeve profesionale të fushës së DDD-së.

Prandaj, kriteret e vendosura nuk janë diskriminuese dhe as të paarsyeshme, por janë të lidhura drejtpërdrejt me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e kontratës, duke synuar garantimin e realizimit të saj në mënyrë efikase, profesionale dhe në përputhje me standardet e kërkuara të mbrojtjes së shëndetit publik.

#### **Përfundim**

Bazuar në të lartcekurat, AK konsideron se në të gjitha veprimet dhe aktet e AK-së gjatë këtij procesi të prokurimit, përfshirë përmbajtjen e Dosjes së Tenderit, ka vepruar në pajtueshmëri të plotë me të gjitha dispozitat përkatëse ligjore të LPP-së dhe legjislacionit sekondar RRPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë kushtet dhe kriteret që paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, Autoriteti Kontraktues, në pajtim me nenin 108/A në paragrafin 10, nënparagrafi 1 të LPP-së dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 pika (a) e Rregullores Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

**Kujtim Bajrami**

**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**

#### **7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit,*

*dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**, pasi kriteret e vendosura në Dosjen e Tenderit janë të mbingarkuara, kufizuese dhe joproportionale, duke zvogëluar konkurrencën dhe mundësinë e Autoritetit Kontraktues për të pranuar oferta më konkurruese dhe ekonomikisht më të favorshme.

**Neni 7 – Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi / Transparenca**, pasi kriteret e vendosura trajtojnë në mënyrë të pabarabartë operatorët ekonomikë të licencuar për kryerjen e shërbimeve DDD dhe krijojnë efekt diskriminues e potencialisht favorizues për operatorë të caktuar ekonomikë.

**Neni 27 – Dosja e Tenderit**, pasi Dosja e Tenderit është përgatitur me kriteret që nuk janë të domosdoshme, proporcionale dhe të lidhura në mënyrë të drejtë me objektin e kontratës.

**Neni 51 – Kriteret e Përzgjedhjes**, pasi kriteret minimale të përzgjedhjes nuk janë kufizuar vetëm në ato që janë të nevojshme për të dëshmuar aftësinë teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik për ekzekutimin e kontratës.

**Neni 66 – Përshtatshmëria Profesionale**, pasi nuk kontestohet e drejta e AK-së për të kërkuar leje valide nga MPBZHR për shërbimet DDD; mirëpo AK ka tejkalluar këtë dispozitë duke vendosur profile profesionale më të ngushta si kushte eliminatorë, duke e zëvendësuar praktikisht organin licencues në përcaktimin e profileve profesionale të pranueshme për ushtrimin e veprimtarisë DDD.

**Neni 69 – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale**, pasi kërkesat për staf profesional, certifikime DDD/IPM, përvojë të ngjashme, pajisje dhe automjete janë vendosur në mënyrë kumulative, të rënduar dhe joproportionale me objektin e kontratës.

**Neni 70 – Standardet për Sigurimin e Cilësisë**, pasi certifikatat ISO/EN janë kërkuar si kushte kumulative eliminatorë, pa u formuluar qartë pranimi i certifikatave të barasvlershme ose dëshmime të tjera ekuivalente.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues dyshohet se ka vepruar në kundërshtim me **Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik**, veçanërisht:

**Neni 17.17**, pasi Dosja e Tenderit nuk duhet të përgatitet në mënyrë që kufizon konkurrencën ose diskriminon/favorizon një apo më shumë operatorë ekonomikë.

**Neni 25.17**, pasi të gjitha kërkesat minimale për kualifikim duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës.

**Neni 25.18**, pasi kriteret minimale nuk duhet të përjashtojnë operatorë ekonomikë që posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme teknike/profesionale për realizimin e kontratës.

**Neni 1 – Qëllimi i Ligjit**, pasi me mbajtjen në fuqi të kriterëve kufizuese dhe diskriminuese, aktiviteti i prokurimit nuk siguron përdorim efikas, transparent, të drejtë dhe konkurrues të fondeve publike.

**Neni 28 – Specifikimet Teknike**, pasi disa kërkesa për pajisje dhe kapacitete teknike janë formuluar në mënyrë të ngurtë, jo funksionale dhe pa arsyetim të mjaftueshëm lidhur me barasvlefshmërinë, duke kufizuar konkurrencën dhe mundësinë e operatorëve ekonomikë për të ofruar zgjidhje teknike ekuivalente.

**Neni 108/A – Kërkesa për Rishqyrtim**, pasi Autoriteti Kontraktues, në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, nuk i ka trajtuar në mënyrë të plotë, konkrete dhe të arsyetuar pretendimet ankimore. AK ka dhënë arsyetime të përgjithshme, pa dëshmuar në mënyrë objektive pse secili kriter i kontestuar është i domosdoshëm, proporcional dhe i pazëvendësueshëm për objektin e kontratës.

*\*\* Sipas Nenet 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

### **1. Kriteret për stafin profesional janë të ngushta, kumulative dhe diskriminuese**

Në Dosjen e Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që Operatori Ekonomik të angazhojë staf me përbërje shumë specifike, duke përfshirë:

- një epidemiolog me certifikatë universitare, licencë pune valide dhe kontratë pune;
- një Bachelor të Shkencave të Mjekësisë Sanitare;

- së paku 3 punëtorë profesional me eksperiencë në lëmin e DDD-së, të dëshmuar me certifikatë aplikuesi të biocideve dhe lëndëve DDD;
- 5 teknikë të certifikuar Integrated Pest Management;
- një teknik të menaxhimit të emergjencave me diplomë;
- dy teknikë të certifikuar për siguri dhe shëndet në punë.

Këto kërkesa janë vendosur si kushte të detyrueshme dhe kumulative, pa u lejuar operatorëve ekonomikë të dëshmojnë kapacitete profesionale të barasvlershme në forma të tjera. Kjo qasje është diskriminuese, sepse për shërbimet DDD dokumenti bazë profesional dhe ligjor është leja valide e lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Nuk kontestohet kërkesa për leje valide nga MPBZHR. Përkundrazi, kjo kërkesë është relevante dhe e lidhur me objektin e kontratës. Mirëpo, nëse një Operator Ekonomik posedon leje valide nga organi kompetent për kryerjen e shërbimeve DDD, atëherë AK nuk duhet të vendosë kritere shtesë që praktikisht krijojnë një “licencim paralel” përmes Dosjes së Tenderit.

Organi kompetent për licencim është ai që përcakton se cilat profile profesionale janë të pranueshme për ushtrimin e veprimtarisë DDD. Autoriteti Kontraktues nuk mund ta zëvendësojë organin licencues duke përcaktuar vetë një kombinim më të ngushtë dhe më eliminues të profesioneve. Nëse sistemi i licencimit pranon profile të ndryshme profesionale për pajisje me leje DDD, AK nuk mund të kufizojë pjesëmarrjen vetëm në operatorë që kanë pikërisht epidemiolog, bachelor të mjekësisë sanitare, teknik të emergjencave dhe teknikë të sigurisë/shëndetit në punë.

Këto profile mund të kenë vlerë në situata të caktuara, mirëpo kjo nuk i bën automatikisht kushte të domosdoshme eliminatore për çdo operator ekonomik, përderisa operatori ekonomik posedon leje valide për DDD dhe staf të mjaftueshëm profesional për realizimin e shërbimit.

Në Vendimin për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, AK arsyeton se epidemiologu dhe Bachelor i Shkencave të Mjekësisë Sanitare janë të rëndësishëm për shëndetin publik, mbikëqyrjen sanitare dhe kontrollin e vektorëve. Megjithatë, ky arsyetim mbetet i përgjithshëm dhe nuk dëshmon pse këto profile duhet të jenë kushte të detyrueshme eliminatore, dhe pse nuk mund të pranohen profile të tjera profesionale të barasvlershme të njohura nga sistemi i licencimit për DDD.

Po ashtu, kërkesa për teknik të menaxhimit të emergjencave me diplomë dhe dy teknikë të certifikuar për siguri dhe shëndet në punë nuk është arsyetuar si domosdoshmëri konkrete për objektin e kësaj kontrate. Shërbimi që prokurohet është dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim, ndërsa këto kërkesa shtesë e zgjerojnë artificialisht strukturën e stafit përtej nevojës reale të kontratës.

Në këtë mënyrë, AK ka vendosur kritere të cilat nuk janë proporcionale, nuk janë të domosdoshme dhe nuk janë të lidhura mjaftueshëm me objektin e kontratës, duke krijuar efekt kufizues dhe diskriminues ndaj operatorëve ekonomikë të licencuar për shërbime DDD.

## **2. Kërkesa për 3 punëtorë profesional DDD dhe njëkohësisht 5 teknikë të certifikuar Integrated Pest Management është e dyfishtë dhe joproporcionale**

Në Dosjen e Tenderit kërkohen njëkohësisht së paku 3 punëtorë profesional me eksperiencë në lëmin e DDD-së, të dëshmuar me certifikatë aplikuesi të biocideve dhe lëndëve DDD, si dhe 5 teknikë të certifikuar Integrated Pest Management.

Këto dy kategori nuk duhet të kërkohen në mënyrë kumulative si të dyja të domosdoshme. Për objektin e kontratës, duhet të mjaftojë që Operatori Ekonomik të dëshmojë njërën prej këtyre dy alternativave profesionale, për aq sa stafi i prezantuar është i mjaftueshëm dhe i kualifikuar për realizimin e shërbimeve DDD.

Vendosja e të dy kërkesave njëkohësisht e dyfishon kriterin profesional dhe e rrit artificialisht prapen e pjesëmarrjes. AK nuk ka dhënë arsytim bindës se pse për këtë shërbim është e domosdoshme që OE të ketë njëkohësisht edhe staf të certifikuar për aplikim të biocideve dhe lëndëve DDD, edhe 5 teknikë të certifikuar IPM.

Në Vendimin për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, AK ka theksuar se përdorimi i biocideve dhe koncepti Integrated Pest Management janë të rëndësishme për realizimin cilësor dhe të sigurt të shërbimeve DDD. Kjo nuk kontestohet. Çështja kontestuese është se AK i ka vendosur këto dy forma certifikimi/trajnimi si kushte të dyfishta dhe kumulative, në vend që të pranojë dëshmi profesionale alternative të barasvlershme për kapacitetin teknik të OE-së.

Kjo kërkesë bie ndesh me parimin e proporcionalitetit, sepse në vend që të kërkojë kapacitet të mjaftueshëm për kryerjen e shërbimit, AK kërkon dy forma të certifikimit/trajnimit në mënyrë kumulative. Kjo e kufizon konkurrencën pa pasur nevojë reale të dëshmuar.

## **3. Kërkesa për kontrata të ngjashme në vlerë minimale 300,000.00 EUR në tri vitet e fundit është kufizuese dhe joproporcionale**

Në Dosjen e Tenderit është kërkuar që Operatori Ekonomik të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit, në vlerë minimale prej 300,000.00 EUR.

Nuk kontestohet e drejta e AK-së për të kërkuar përvojë të ngjashme. Mirëpo, kërkesa për përvojë duhet të jetë proporcionale me objektin dhe natyrën reale të kontratës. Në këtë rast kemi të bëjmë me kontratë publike kornizë 36-mujore, ku shërbimet kryhen sipas nevojës dhe sipas urdhërblërjeve të Autoritetit Kontraktues, pa garanci se e gjithë vlera e parashikuar do të realizohet në mënyrë të plotë.

Për më tepër, duke marrë parasysh se kontrata për 36 muajt e fundit për të njëjtin objekt ka qenë në vlerë rreth 110,000.00 EUR, kërkesa për referenca në vlerë minimale prej 300,000.00 EUR paraqet rritje të madhe dhe të paarsyetuar të pragut të kualifikimit. Kjo kërkesë mund të përjashtojë operatorë ekonomikë që kanë kapacitet real dhe përvojë të mjaftueshme për realizimin e kontratës, vetëm për shkak se nuk kanë pasur kontrata të

përqendruara në këtë vlerë brenda tri viteve të fundit.

Kjo kërkesë bëhet edhe më kufizuese kur analizohet së bashku me kriteret e tjera të Dosjes, përfshirë stafin shumë specifik, certifikimet DDD/IPM, pajisjet/automjetet e shumta dhe certifikatat ISO/EN. Efekti i përbashkët i këtyre kriterëve e zvogëlon ndjeshëm konkurrencën dhe e bën pjesëmarrjen të mundshme vetëm për një numër shumë të kufizuar operatorësh.

#### **4. Lista e pajisjeve dhe automjeteve është tepër e detajuar dhe e rënduar si kusht eliminues**

Në Dosjen e Tenderit kërkohet që OE të posedojë ose të ketë në shfrytëzim një numër të madh pajisjesh dhe automjesh, duke përfshirë gjeneratorë ULV, pompa motorike, pompa elektrostatische ULV, pompa B&G ose të ngjashme, gjeneratorë për mjegullim termik, gjenerator elektrik ULV, së paku 5 furgonë/kamionë/xhipa dhe një xhip transportues me korp.

Kjo listë është shumë e detajuar dhe e ngurtë. Për objektin e kontratës, AK duhet të kërkojë kapacitet teknik të mjaftueshëm për realizimin e shërbimit, jo një konfigurim të paracaktuar dhe shumë specifik të pajisjeve dhe automjeteve.

Kriteret teknike duhet të lidhen me rezultatin që duhet të arrihet dhe me aftësinë reale për ekzekutimin e kontratës. Kur AK e përcakton në mënyrë të detajuar numrin dhe llojin e pajisjeve/automjeteve, pa dhënë arsytim të qartë për lidhjen e secilës pajisje me volumin, dinamikën dhe lokacionet konkrete të shërbimit, krijohet efekt kufizues.

Një OE mund të ketë kapacitet të mjaftueshëm për kryerjen e shërbimeve DDD edhe me një organizim teknik të ndryshëm, përderisa i përmbush rezultatet dhe standardet e kërkuara të shërbimit. Prandaj, kërkesa duhet të jetë funksionale dhe proporcionale, jo listë e ngurtë që potencialisht favorizon operatorë të caktuar.

Në Vendimin për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, AK e arsyeton numrin e madh të stafit dhe pajisjeve me territorin e gjerë të komunës, numrin e institucioneve publike dhe nevojën për trajtim të vazhdueshëm. Megjithatë, AK nuk ka paraqitur analizë konkrete mbi volumin real, frekuencën e shërbimeve, numrin e lokacioneve, dinamikën e trajtimeve dhe lidhjen e secilës pajisje/automjet me nevojën objektive të kontratës. Arsyetimi i përgjithshëm për “territor të gjerë” nuk mjafton për ta bërë proporcionale një listë kaq të detajuar dhe të rënduar pajisjesh dhe automjesh si kusht eliminues.

#### **5. Kërkesa për certifikatat ISO/EN si kushte kumulative eliminatore është kufizuese**

Në Dosjen e Tenderit është kërkuar që Operatori Ekonomik të posedojë certifikatat ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001:2018 dhe EN 16636:2015 për shërbimet e dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit.

Kërkimi i të gjitha këtyre certifikatave njëkohësisht si kushte kumulative eliminatore krijon pengesë të panevojshme për konkurrencën. AK duhet të pranojë certifikata të barasvlershme ose dëshmi të tjera të besueshme për masa ekuivalente të sigurimit të cilësisë, mjedisit, sigurisë në punë dhe standardeve profesionale.

Në rastin konkret, Dosja nuk e formulon qartë pranimin e dëshmive ekuivalente dhe i paraqet certifikatat si kushte të detyrueshme. Kjo mund të përjashtojë operatorë ekonomikë të licencuar dhe profesionalisht të aftë, të cilët mund të dëshmojnë masa të barasvlershme për menaxhimin e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve.

Fakti që standardet ISO/EN mund të jenë të dobishme për menaxhimin e cilësisë, mjedisit dhe sigurisë nuk nënkupton se të gjitha duhet të kërkohen njëkohësisht si kushte eliminatore, pa pranuar qartë barasvlershmëri apo dëshmi alternative. Kërkesa e tillë, e vendosur bashkë me kriteret tjera të rënduara, e rrit më tej efektin kufizues të Dosjes.

## **6. Vendimi për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim nuk i ka eliminuar shkeljet**

Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim duke deklaruar se kriteret janë të lidhura me shëndetin publik, kompleksitetin e kontratës dhe nevojën për shërbim profesional. Megjithatë, Vendimi nuk jep analizë konkrete për secilin kriter të kontestuar dhe nuk e dëshmon domosdoshmërinë, proporcionalitetin dhe pazëvendësueshmërinë e tyre.

AK nuk ka arsyetuar pse profilet profesionale të kërkuara duhet të jenë pikërisht ato të përcaktuara në Dosje dhe jo profile alternative të pranuar nga organi licencues. AK nuk ka shpjeguar pse DDD dhe IPM duhet të kërkohen njëkohësisht si kritere kumulative. AK nuk ka arsyetuar pse vlera 300,000.00 EUR për kontrata të ngjashme është proporcionale, sidomos në raport me kontratën paraprake për të njëjtin objekt. AK nuk ka paraqitur analizë konkrete për numrin dhe llojin e pajisjeve/automjeteve të kërkuara. AK nuk ka eliminuar problemin e certifikatave ISO/EN të kërkuara si kushte kumulative.

Për rrjedhojë, Vendimi i AK-së nuk e korrigjon shkeljen, por e konfirmon vazhdimin e saj.

## **7. Efekti kumulativ i kriterëve e bën Dosjen kufizuese dhe diskriminuese**

Në përmbledhje, shkelja nuk qëndron vetëm në një kriter të vetëm. Problemi kryesor është efekti i përbashkët i kriterëve të vendosura nga AK:

- kërkohet leje nga MPBZHR për DDD;
- njëkohësisht AK vendos profile profesionale të ngushta dhe eliminatore;
- kërkohen njëkohësisht 3 punëtorë DDD dhe 5 teknikë IPM;
- kërkohet përvojë e ngjashme në vlerë 300,000.00 EUR;
- kërkohet listë shumë e detajuar dhe e rënduar e pajisjeve/automjeteve;
- kërkohen disa certifikata ISO/EN si kushte kumulative.

Ky kombinim e bën Dosjen e Tenderit të rënduar, kufizuese dhe joproportionale. Në vend

që të kërkojë kapacitet të mjaftueshëm profesional dhe teknik për kryerjen e shërbimeve DDD, AK ka vendosur një strukturë shumë specifike të kriterëve, e cila krijon dyshim të arsyeshëm se konkurrenca është kufizuar dhe se operatorë të caktuar mund të jenë favorizuar.

Kjo është në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit, trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit, proporcionalitetit dhe përgatitjes së drejtë të dokumenteve të tenderit.

Për këto arsye, kërkohet që OSHP ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta anulojë Vendimin e Autoritetit Kontraktues për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim dhe ta obligojë Autoritetin Kontraktues që ta anulojë aktivitetin e prokurimit dhe ta rishpallë atë me Dosje të Tenderit të përgatitur në mënyrë të rregullt, proporcionale, jo-diskriminuese dhe në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

## **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

### **Dëmi material dhe ekonomik konsiston në:**

**rrezikun e përjashtimit nga konkurrimi për shkak të kriterëve kufizuese, joproportionale dhe diskriminuese, e jo për shkak të mungesës së kapacitetit real profesional apo teknik;**

**humbjen e mundësisë reale për të konkurruar dhe për të fituar një kontratë me vlerë të parashikuar prej 350,000.00 EUR;**

**shpenzimet administrative, profesionale dhe operative të bëra për analizimin e Dosjes së Tenderit, përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim dhe përgatitjen e ankesës në OSHP;**

**kostot shtesë të padrejta që do të imponoheshin nëse OE detyrohet të angazhojë profile profesionale ose certifikime që nuk janë të domosdoshme për realizimin e shërbimeve DDD dhe që nuk burojnë si kushte të detyrueshme nga sistemi i licencimit për këtë veprimtari;**

**dëmtimin e pozitës konkurruese të MONUNI SH.P.K. në tregun e shërbimeve DDD, pasi kriteret aktuale favorizojnë operatorë që mund ta kenë pikërisht strukturën e kërkuar nga AK, ndërsa përjashtojnë operatorë të tjerë të licencuar dhe të aftë;**

**humbjen e mundësisë për sigurimin e referencave të reja për kontrata publike të kësaj natyre, të cilat kanë rëndësi për pjesëmarrje në procedura të ardhshme të**

## **prokurimit.**

### **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*